




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve 2008 – 2013





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve 2008 – 2013



Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Shkurt, 2015

© : *Agjencia e Statistikave të Kosovës*

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet: <http://ask.rks-gov.net>

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin e rezultateve të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve për vitin referues 2013.

Hulumtimi i ASN-së për herë të parë ka filluar në vitin 2006 për vitin referues 2005. Nga viti 2006 e këndej ky hulumtim është pjesë përbërëse e Programit statistikor të ASK-së dhe bazohet në deklaratimet e ndërmarrjeve.

Kjo anketë me të dhënat që ofron, synon të paraqet disa nga treguesit ekonomik sipas strukturës së veprimtarive ekonomike.

Rezultatet e këtij hulumtimi në të njëjtën kohë përdoren për nevoja të llogarive kombëtare dhe janë burim i rëndësishëm në përpilimin e Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit.

Ky është publikimi i gjashtë me radhë i kësaj natyre me intencë të vazhdueshme që të jetë publikim i rregullt i ASK-së.

SQARIM: Nga ky vit e tutje nomenklatura e veprimtarive ekonomike është në versionin e ri NACE Rev. 2, po ashtu edhe të dhënat e publikuara për vitet paraprake janë konvertuar në këtë version.

Komentet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura.

Publikimi është përgatitur nga :

Ilir T. Berisha - Drejtor i Departamentit

Ismail Sahiti – Shef i divizionit

Hysni Elshani - Shef i sektorit të statistikave ekonomike

Luljeta Krasniqi - Çela – Zyrtare

Valdete Navakazi - Zyrtare

Muhamet Kastrati - Menaxher i bazës së të dhënave të RSB-së

Ahmet Cakolli – Zyrtar për dizajn

Shkurt, 2015

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,
z. Isa Krasniqi

Lista e shkurtesave

- ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
- ASN - Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
- BPV - Bruto Produkti Vendor
- NVE - Nomenklatura e veprimtarive ekonomike
- ATK - Administrata Tatimore e Kosovës
- ARBK - Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
- KE - Komisioni Evropian
- RSB - Regjistri Statistikorë i Bizneseve

Simbolet

: Mungojnë të dhënat

n/a Nuk aplikohet

Përmbajtja

	Faqe
1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës	4
1.1. Objektivi.....	4
1.2. Metodologjia dhe shtrirja e anketës	4
1.3. Korniza dhe përzgjedhja e mostrës.....	6
1.4. Dizajnimi dhe përmbajtja e pyetësorit	6
1.5. Procedurat e mbledhjes së të dhënave	8
1.6. Ngritja e të dhënave të anketës në nivel të vendit	8
2 Definicionet, përkufizimet dhe treguesit themelorë	9
2.1. Definicione dhe përkufizime	9
2.2. Treguesit themelorë	9
3 Numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe paga mesatare	10
3.1. Numri i ndërmarrjeve sipas seksioneve ekonomike	10
3.2. Numri i të punësuarve sipas seksioneve ekonomike	11
3.3. Paga mesatare sipas seksioneve ekonomike	13
4 Qarkullimi dhe shpenzimet	14
4.1. Qarkullimi.....	14
4.2. Shpenzimet.....	15

1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës

1.1. Objektivi

Objektivi kryesor i Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN) është paraqitja e strukturës së aktiviteteve ekonomike të ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike në Kosovë nëpërmjet disa treguesve ekonomik. Të mundësojë krahasimin e të dhënave në nivel ndërkombëtar duke pasur parasysh standardet Evropiane për statistikat strukturore dhe Sistemin Evropian për llogarit kombëtare.

Anketa synon t'i plotësojë kërkesat për informacion më të plotë statistikor në kushtet e ekonomisë së tregut dhe ofron të dhëna mbi aktivitetin ekonomik të ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet në të gjithë territorin e vendit.

1.2. Metodologjia dhe shtrirja e anketës

Metodologjia e përdorur për përpilimin e instrumenteve për anketë, nomenklatura dhe përgatitja e të dhënave për publikim është sipas rregullave dhe rekomandimeve të Eurostat-it.

Pyetësi është rishikuar çdo vit me qëllim të rritjes së cilësisë së të dhënave dhe përafrimit me Rregulloren Nr. 295/2008 të Komisionit Evropian (KE) për statistikat strukturore të ndërmarrjeve me qëllim që të dhënat të jenë të krahasueshme me vendet tjera.

Anketa është kryer në tërë territorin e Kosovës dhe përfshinë të dhënat për këto aktivitete ekonomike si: industri nxjerrëse (miniera, gurthyes dhe seperacione të zhavorrit), industri përpunuese (prodhimi), furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar, furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës, ndërtim, tregti, hotele dhe restorante, transport dhe telekomunikacion, shërbime tjera biznesore.

Në anketë nuk përfshihen këto degë: bujqësia, gjuetia dhe pylltaria, peshkimi, financat, administrata publike, arsimit, shëndetësia dhe aktivitetet e ekonomive familjare pasi që këto degë janë pjesë e hulumtimeve tjera.

Afati për grumbullimin e të dhënave nga terreni ka qenë brenda intervalit kohor prej një muaji e gjysmë deri dy muaj.

Bashkëpunimi me ndërmarrjet për realizimin e kësaj ankete ishte i kënaqshëm.

Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE-NACE Rev2)¹.

Seksionet ekonomike	
A	Bujqësi, pylltari dhe peshkatori
B	Xehtari dhe gurëthyes
C	Prodhim
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës
F	Ndërtimtari
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi I mjeteve, motoçikletave
H	Transporti dhe magazinimi
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim
J	Informacion dhe komunikim
K	Aktivitete financiare dhe të sigurimit
L	Aktivitete të patundshmërisë
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike
N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse
O	Administratë publike dhe mbrojtje; sigurimi social i detyrueshëm
P	Arsim
Q	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale
R	Art, zbavitje dhe rekreacion
S	Aktivitete të shërbimeve tjera
T	Aktivitete të ekonomive familjare si punëdhënës; mallra dhe shërbime të pandara-aktivitete prodhuese shtëpiake për përdorim vetanak
U	Aktivitete të organizatave dhe organeve jashtë-territoriale

Seksionet ekonomike pjesë ASN 2013	
B	Xehtari dhe gurëthyes
C	Prodhim
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës
F	Ndërtimtari
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi I mjeteve, motoçikletave
H	Transporti dhe magazinimi
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim
J	Informacion dhe komunikim
L	Aktivitete të patundshmërisë
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike
N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse
R	Art, zbavitje dhe rekreacion
S	Aktivitete të shërbimeve tjera

¹ Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE-NACE Rev2) është standard unik për klasifikimin e ndërmarrjeve sipas aktivitetit të tyre ekonomik, shërben për përpunimin e të dhënave statistikore dhe ka gjetur zbatim në të gjitha vrojtimet pranë ndërmarrjeve.

1.3. Korniza dhe përzgjedhja e mostrës

Korniza e mostrës përbëhet nga lista e ndërmarrjeve aktive që mbahen në Regjistrin Statistikorë të Bizneseve (RSB) i cili funksionon në kuadër të ASK-së. Sipas metodologjisë së përdorur në statistikë ndërmarrje aktive konsiderohen vetëm ato që kanë deklaruar njërin nga tatimet apo kanë deklaruar ndonjë të punësuar gjatë vitit referues.

Mostra është nxjerre duke përdorur zgjedhjen e rastësishme të bizneseve për secilën klasë të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike me qëllim të përfshirjes në nivel sa më të lartë të qarkullimit për të gjitha aktivitetet ekonomike.

Tabela 1. Numri i ndërmarrjeve dhe madhësisë së mostrës për ASN për vitet 2008-2013

Popullacioni i ndërmarrjeve për vitin 2013		2008	2009	2010	2011	2012	2013
1	Korniza (Popullimi)	41117	42079	41362	41418	41750	29057
2	Mostra	3677	3677	2310	1317	2300	4491
3	Madhësia e mostrës %	9	9	6	3	6	15
	Përgjigje (a+b)	2236	2310	1572	1080	1627	2176
4	a) Përgjigje të kompletuara	2231	2279	1557	1060	1610	2115
	b) Me përgjigje jo complete	5	31	15	20	17	61
5	Norma e përgjigjeve %	61	62	67	80	70	48
6	Pa përgjigje*	1441	1367	738	237	673	2315

1.4. Dizajnimi dhe përmbajtja e pyetësorit

Dizajnimi dhe përmbajtja e pyetësorit është bërë duke u bazuar në rregulloren e KE për statistikat strukturore të ndërmarrjeve të cekur më lartë. Po ashtu pyetësorit i janë shtuar edhe elemente (pyetje) që mund të përdoren për qëllime tjera tek statistikat ekonomike dhe llogaritë kombëtare.

Pyetësori për nga struktura ka qenë i dizajnuar për të gjitha llojet e ndërmarrjeve sa i përket sektorit ekonomik, edhe pse në disa raste disa pjesë kanë qenë specifike vetëm për kategori të caktuar të ndërmarrjeve siç është rasti i atyre që merren me ndërtimtari dhe industri.

Fillimisht *pjesa e parë* ka qenë identifikimi i ndërmarrjes me të dhëna si: numri i regjistrimit të biznesit, numri fiskal, emri i biznesit, adresa e saktë, përshkrimi i aktivitetit ose aktiviteteve nëse ka pasur dy a më tepër aktivitete, forma ligjore e biznesit si dhe pronësia e ndërmarrjes.

Pjesa e dytë specifike është ndarë sipas tabelave apo në kapituj:

Kështu tabela e parë përmban: Numrin e muajve aktiv të ndërmarrjes.

Tabela e dytë përmban: numrin e të punësuarve, numrin e pronarëve që punojnë, numrin e anëtarëve të familjes që punojnë pa pagesë dhe numrin e të punësuarve me pagesë. Të gjitha këto të ndara në kategori sipas gjinisë².

Tabela e tretë ka të bëjë me qarkullimin e ndërmarrjeve dhe atë për mallrat e prodhuara nga ndërmarrja, mallrat nga tregtia dhe shërbimet, nën-kontraktuesit si dhe të ardhurat tjera. Kjo tabelë është e lidhur me tabelën VI të pyetësorit për ndërmarrjet që kanë pasur dy e më tepër aktivitete ekonomike është shtuar si aneks ky kapitull, zbërthimi i indikatorëve kryesor për informim analitik me qëllim të identifikimit të aktivitetit kryesor dhe aktiviteteve tjera.

Tabela e katërt përshinë blerjet që ndërmarrja ka kryer për zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Në këtë tabelë përfshihen shpenzimet totale për material të ndërmarrjes pastaj shpenzimet totale për konsum të ndërmjetëm, koston e personelit pagat dhe mëditjet, shpenzimet e sigurimit social si dhe tatimet, taksat dhe licencat e paguara nga ndërmarrja për periudhën brenda vitit kalendarik dhe pagesat tjera që nuk janë në funksion të prodhimit .

Tabela e pestë ka të bëjë me ndryshimin e stokeve në fillim dhe në fund të vitit kalendarik për lëndën e parë dhe të konsumueshme , puna në progres, mallrat e përfunduara, mallrat për rishitje si dhe të tjera.

Tabela e gjashtë ka të bëjë me zbërthimin e indikatorëve kryesor duke specifikuar qarkullimin, numrin e të punësuarve, pagat, stoqet si dhe investimet e mallrave për secilin aktivitet që ushtron ndërmarrja për periudhën brenda vitit kalendarik.

Tabela e shtatë ka të bëjë me konsumin e ndërmjetmë ku specifikohen të gjitha shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve, pastaj ndryshimi i stokeve për mallrave të gatshme dhe të papërfunduara si dhe ndryshimi i stokeve për mallrat për rishitje.

Tabela e tetë ka të bëjë me investimet kapitale dhe ato të kategorizuara si në: Kërkime minerale, programe kompjuterike, patenta, marka dhe të tjera pastaj investimet në tokë, ndërtesa dhe ndërtime tjera, makineri dhe pajisje, përfshirë edhe kompjuterët, vetura dhe mjete tjera të transportit dhe ndërtime apo prodhime për nevojat e tyre.

Tabela nëntë ka të bëjë me investimet sipas origjinës për makineri dhe pajisje të specifikuara sipas aktivitetit ekonomik.

Tabela dhjetë ka të bëjë me qarkullimin e transportit sipas llojit të mallrave të transportuara.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të anketës në tërësi, faqja e fundit e pyetësorit është paraparë për vërejtje dhe komente të intervistuarve që kryesisht kanë qenë kontabilistët e ndërmarrjeve.

² Kjo ndarje është kryer për nevoja të statistikave gjinore.

1.5. Procedurat e mbledhjes së të dhënave

Në mbledhjen e të dhënave ne kemi aplikuar metodat të cilat i kemi konsideruar më efikase për kushtet dhe rrethanat në vendin tonë.

Anketimi pjesërisht është kryer me metodën e intervistimit të drejtpërdrejt në rastet kur kjo ka qenë e mundur apo thënë ndryshe kur personat përgjegjës pranë ndërmarrjeve kanë pasur mundësi për një gjë të tillë.

Në raste të caktuara kur intervista ka qenë e pamundur të realizohet drejtpërdrejt pyetësorët u janë lënë personave përgjegjës pranë ndërmarrjeve me qëllim të plotësimit të tyre dhe pas disa ditëve të njëjtit të plotësuar janë marrë nga anketuesit. Vetëm tek një numër i vogël i ndërmarrjeve mundësitë për mbledhjen e të dhënave në mënyrë elektronike janë zbatuar (e-mail).

1.6. Ngritja e të dhënave të anketës në nivel të vendit

Të dhënat nga anketa strukturore e ndërmarrjeve janë peshuar me qëllim të përfitimit të rezultateve në nivel të vendit . Peshat janë kalkuluar duke marrë për bazë numrin e të punësuarve për aktivitetin ekonomik të caktuar. Për verifikim të rezultateve të fituara sipas degëve janë përdorur edhe tregues tjerë si p.sh. qarkullimi si dhe informacione tjera nga RSB.

2 Definicionet, përkufizimet dhe treguesit themelorë

2.1. Definicione dhe përkufizime

Ndërmarrja është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Ndërmarrje aktive – konsiderohen vetëm ato ndërmarrje që kanë deklaruar njërin nga tatimet apo ndonjë të punësuar për vitin referues.

Të punësuarit përfshijnë të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjesëtarët e familjes që punojnë pa pagesë.

Vlera e qarkullimit përfshin shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë periudhës referuese dhe i korrespondon shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve ofruar të tjerëve.

Shpenzimet apo blerjet paraqesin shumën apo vlerën totale të blerjeve të realizuara nga ana e ndërmarrjes për nevoja të afarizmit brenda vitit kalendarik.

2.2. Treguesit themelorë

Numri total i ndërmarrjeve aktive brenda periudhës së vrojtuar ka qenë 29057³.

Sa i përket sektorëve ekonomik numri më i madh i ndërmarrjeve i takon tregtisë me 16091 ndërmarrje apo shprehur në përqindje (55.4%), industria përpunuese 3736 (12.9%), akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 3126 (10.8%), ndërtimtaria me 2094 (7.2%), shërbimet biznesore dhe shërbimeve tjera me 1897 (6.5%), transporti, depot dhe telekomunikacioni me 1166 (4.0%), informacione dhe komunikim me 626 (2.2%), industria nxjerrëse 149 (0.5%), furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës me 144 (0.5) si dhe prodhimi, furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar arrijnë rreth 28 (0.1%).

Ndërsa sa i përket punësimit për sektorët ekonomik të cilat ishin pjesë e hulumtimit del që numri total i të punësuarve arrin shifrën 149886, prej te cilëve sektori i tregtisë përbën rreth 57379 të punësuar apo shprehur në përqindje (38.3%), industria përpunuese 22932 (15.3%), ndërtimtaria me 16297 (10.9%), shërbimet biznesore 12297 (8.2%), akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 11174 (7.5%), furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar 9025 (6.0%), si dhe sektorët tjerë kanë më pak se 5% të punësuar.

Karakteristik tjetër që vlen të përmendet është edhe qarkullimi i realizuar nga ndërmarrjet e që prapë dominon tregtia me një pjesëmarrje prej 55.7%, industria përpunuese 11.8%, ndërtimtaria me 10.5%, kurse sektorët e tjerë të veprimtarive ekonomike rezultojnë me një përqindje më të vogël të qarkullimit.

Dhe për fund treguesi i pagës mesatare mujore që sillet rreth 349 Euro në aktivitetet e përfshira në anketë e që është një tregues i përafërt me realitetin tonë.

³ Ndërmarrje aktive për vitin 2013 janë konsideruar vetëm ndërmarrjet të cilat janë përdorur si kornizë për mostrën e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve .

3 Numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe paga mesatare

3.1. Numri i ndërmarrjeve sipas seksioneve ekonomike

Gjatë vitit 2013 në bazë të kriterit të deklarimit të njërit nga tatimet, numri i ndërmarrjeve aktive ka qenë rreth 29057. Ky numër është konsideruar kornizë për mostër për ASN 2013. Në këtë numër nuk janë të përfshira këto aktivitete: bujqësia, pylltaria, peshkimi, financat, arsimi, shëndetësia, aktivitete e ekonomive familjare si dhe administrata publike.

Tabela 2. Numri i ndërmarrjeve aktive sipas seksioneve ekonomike për vitet 2008-2013

Seksionet	Përshkrimi i seksioneve ekonomike	2008	2009	2010	2011	2012	2013
B	Xehtari dhe gurëthyes	206	199	204	201	229	149
C	Prodhim	4065	4103	4112	4246	4598	3736
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	46	52	63	59	68	28
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	1414	1449	1874	1546	1685	144
F	Ndërtimtari	2362	2456	2564	2702	3038	2094
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve, motoçikletave	20815	21125	19775	19791	20509	16091
H	Transporti dhe magazinimi	1213	1228	1135	1168	1160	1166
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	3498	3559	3364	3459	3715	3126
J	Informacion dhe komunikim	3615	3706	3731	3696	3563	626
L,M,N,R,S	Aktivitete të shërbimeve tjera	3891	4209	4241	4558	3192	1897
Gjithsej		41124	42086	41063	41425	41757	29057

Tabela 3. Struktura e ndërmarrjeve sipas seksioneve ekonomike për vitet 2008-2013

Seksionet	Përshkrimi i seksioneve ekonomike	2008	2009	2010	2011	2012	2013
B	Xehtari dhe gurëthyes	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5
C	Prodhim	9,9	9,7	10,0	10,3	11,0	12,9
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	0,1	0,1	0,2	0,1	0,2	0,1
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	3,4	3,4	4,6	3,7	4,0	0,5
F	Ndërtimtari	5,7	5,8	6,2	6,5	7,3	7,2
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve, motoçikletave	50,6	50,2	48,2	47,8	49,1	55,4
H	Transporti dhe magazinimi	3,0	2,9	2,8	2,8	2,8	4,0
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	8,5	8,5	8,2	8,4	8,9	10,8
J	Informacion dhe komunikim	8,8	8,8	9,1	8,9	8,5	2,2
L,M,N,R,S	Aktivitete të shërbimeve tjera	9,5	10,0	10,3	11,0	7,6	6,5
Gjithsej		100	100	100	100	100	100

Vërehet se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve deklaruese gjatë vitit 2013 i përket sektorit të tregtisë me (55.4%). Pjesa tjetër janë nga sektorët: industri përpunuese (prodhim) me (12.9%), akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me (10.8%), ndërtimtari me (7.2%), shërbime tjera me (6.5%), transporti, dhe magazinimi me (4.0%) etj. Një strukturë ndryshe nga kjo është ajo për numrin e të punësuarve sipas seksioneve ekonomike.

3.2. Numri i të punësuarve sipas seksioneve ekonomike


Numri i përgjithshëm i të punësuarve gjatë viteve 2008 - 2013 ka qenë ndërmjet 89 mijë dhe 150 mijë. Në këtë numër nuk bëjnë pjesë të punësuarit në sektorët e veprimtarive ekonomike: bujqësi, pylltari, peshkim, financa, kompani të sigurimeve, arsim, shëndetësi, aktivitete e ekonomive familjare dhe administratë publike.

Tabela 4. Numri i të punësuarve sipas seksioneve ekonomike për vitet 2008-2013

Seksionet	Përshkrimi i seksioneve ekonomike	2008	2009	2010	2011	2012	2013
B	Xehtari dhe gurëthyes	2943	3796	3694	4297	3027	2636
C	Prodhim	16183	16748	17827	19204	25213	22932
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	7444	8031	8251	8946	9104	9025
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	4158	5062	5381	5345	5645	4047
F	Ndërtimtari	7248	10300	13676	14993	17779	16297
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve, motoçikletave	27207	31461	35538	39459	47302	57379
H	Transporti dhe magazinimi	5672	6765	7186	7677	9203	7043
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	6478	6992	7432	6356	7389	11174
J	Informacion dhe komunikim	4286	5199	5527	5722	6806	7056
L,M,N,R,S	Aktivitete të shërbimeve tjera	7223	10369	10595	11220	13965	12297
Gjithsej		88843	104723	115107	123218	145433	149886

Tabela 5. Shpërndarja e të punësuarve sipas seksioneve ekonomike për vitet 2008-2013

Seksionet	Përshkrimi i seksioneve ekonomike	2008	2009	2010	2011	2012	2013
B	Xehtari dhe gurëthyes	3,3	3,6	3,2	3,5	2,1	1,8
C	Prodhim	18,2	16,0	15,5	15,6	17,3	15,3
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	8,4	7,7	7,2	7,3	6,3	6,0
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	4,7	4,8	4,7	4,3	3,9	2,7
F	Ndërtimtari	8,2	9,8	11,9	12,2	12,2	10,9
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve, motoçikletave	30,6	30,0	30,9	32,0	32,5	38,3
H	Transporti dhe magazinimi	6,4	6,5	6,2	6,2	6,3	4,7
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	7,3	6,7	6,5	5,2	5,1	7,5
J	Informacion dhe komunikim	4,8	5,0	4,8	4,6	4,7	4,7
L,M,N,R,S	Aktivitete të shërbimeve tjera	8,1	9,9	9,2	9,1	9,6	8,2
Gjithsej		100	100	100	100	100	100

Grafikoni 1. Shpërndarja e të punësuarve sipas seksioneve ekonomike për vitet 2008-2013

Sa i përket shpërndarjes së të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike përsëri vërehet se pjesa më e madhe janë në sektorin e tregtisë dhe sillet në mes të 30.0 dhe 38.1%. Tregtia në Kosovë karakterizohet me numër të madh të ndërmarrjeve të vogla me pak të punësuar, kryesisht janë biznese familjare me një të punësuar apo të vetëpunësuar edhe pse në këtë sektor kemi disa ndërmarrje të cilat kanë 100 e më tepër të punësuar. Të punësuarit tjerë janë kryesisht në sektorin e industrisë përpunuese (prodhim) me (15.3 – 18.2%), ndërtimtari (8.2 – 12.2%) aktivitetet e shërbimeve tjera (8.1 – 9.9%) e kështu me radhë.

3.3. Paga mesatare sipas seksioneve ekonomike

Paga mesatare është një tregues me rëndësi. Ajo është kalkuluar duke pjesëtuar pagat dhe mëditjet bruto⁴ fillimisht me numrin e të punësuarve e pastaj me 12 muajt e vitit.


Tabela 6. Paga mesatare sipas seksioneve ekonomike për vitet 2008-2013

Seksionet	Përshkrimi i seksioneve ekonomike	2008	2009	2010	2011	2012	2013
B	Xehitari dhe gurëthyes	348	357	382	383	561	461
C	Prodhim	228	228	227	248	275	332
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	486	469	555	557	564	608
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	197	197	210	214	219	360
F	Ndërtimtari	216	221	227	275	360	319
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve, motoçikletave	218	207	206	252	274	305
H	Transporti dhe magazinimi	257	260	262	263	263	366
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	208	217	221	220	269	266
J	Informacion dhe komunikim	776	783	792	829	852	707
L,M,N,R,S	Aktivitetet të shërbimeve tjera	235	238	255	302	334	273
Gjithsej		275	272	280	309	338	349

**Ndryshimet që vërehen tek sektori H dhe J janë për shkak të ndarjes së sektorit transporti, depot dhe telekomunikacioni (sipas nomenklaturës NACE Rev.2) në dy sektore të reja,, si transporti dhe magazinimi dhe sektori tjetër Informacion dhe komunikim. Ndryshime të ngjashme vërehen edhe në tabelat tjera .*

Treguesi i pagës mesatare i cili është në mes 272 e 349 Euro për vitet 2008 - 2013 në aktivitetet e përfshira në anketë është një tregues i përafërt me realitetin tonë. Siç edhe mund të vërehet paga mesatare më e lartë është në sektorin informacion dhe komunikim, derisa ajo më e ulëta është në sektorin e akomodimit dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim.

Grafikoni 2. Paga mesatare sipas seksioneve ekonomike për vitet 2008-2013



⁴ Në pagën bruto është konsideruar edhe pjesa e pensionit që pronari paguan për punëtorin.

4 Qarkullimi dhe shpenzimet

4.1. Qarkullimi


Vlera e qarkullimit përfshinë shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë periudhës së marrë në shqyrtim dhe i korrespondon shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve ofruar të tjerëve.

Tabela 7. Struktura e qarkullimit sipas seksioneve ekonomike për vitet 2008-2013

Seksionet	Përshkrimi i seksioneve ekonomike	2008	2009	2010	2011	2012	2013
B	Xehitari dhe gurëthyes	3,1	2,9	2,8	3,0	0,8	0,8
C	Prodhim	11,6	10,6	10,7	11,3	12,4	11,8
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	4,5	4,3	4,9	4,2	4,2	4,5
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	1,1	1,0	1,1	1,0	1,1	0,7
F	Ndërtimtari	9,3	9,9	9,7	12,7	11,5	10,5
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve, motoçikletave	55,6	57,3	57,1	55,4	56,9	55,7
H	Transporti dhe magazinimi	5,6	5,1	4,9	4,2	4,3	2,7
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	1,2	1,1	1,1	1,0	1,1	1,3
J	Informacion dhe komunikim	4,1	3,8	3,8	3,4	3,6	4,7
L,M,N,R,S	Aktivitete të shërbimeve tjera	3,8	4,0	3,9	3,8	4,0	7,3
Gjithsej		100	100	100	100	100	100

Qarkullimi më i madh i realizuar nga ndërmarrjet sipas viteve vërejmë se është në sektorin e tregtisë, kështu vlera e qarkullimit të realizuar nga sektori i tregtisë sillet në mes të 55.7 dhe 57.3% dhe kryesisht ka të bëjë me ndërmarrje të mesme, kurse sektorët e tjerë të veprimtarive ekonomike rezultojnë me një përqindje më të vogël të qarkullimit. Kështu ndër sektorët të cilët kanë përqindje më të vogël të qarkullimit është sektori ku bëjnë pjesë ndërmarrjet nga xehetaria dhe gurëthyesit me 0.8 dhe 3.1% dhe furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës me 0.7 dhe 1.1% ejt.

Grafikoni 3. Qarkullimi sipas seksioneve ekonomike për vitet 2008-2013




4.2. Shpenzimet

Tabela 8. Shpenzimet në bazë të seksioneve ekonomike për vitet 2008-2013

Seksionet		2008	2009	2010	2011	2012	2013
B	Xehtari dhe gurëthyes	1,8	2,2	2,6	4,1	0,7	0,5
C	Prodhim	12,2	9,6	12,8	11,4	10,2	11,8
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	4,8	4,6	4,7	5,0	3,9	3,1
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	0,9	0,9	1,0	0,8	0,7	0,3
F	Ndërtimtari	8,7	8,8	9,2	12,8	11,6	8,1
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve, motoçikletave	59,2	63,3	57,8	55,9	62,0	63,4
H	Transporti dhe magazinimi	2,4	2,0	2,2	2,2	2,2	2,4
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	1,1	0,9	1,0	0,5	0,9	0,8
J	Informacion dhe komunikim	5,7	4,8	5,4	5,0	5,1	2,1
L,M,N,R,S	Aktivitete të shërbimeve tjera	3,2	2,8	3,2	2,3	2,7	7,5
Gjithsej		100	100	100	100	100	100

Duke u bazuar në anketën strukturore të ndërmarrjeve për vitet 2008 - 2013 vërejmë se edhe tek shpenzimet apo blerjet dominon seksioni i tregtisë me një përqindje prej 55.9 dhe 63.4% të vlerës totale të të gjitha aktiviteteve. Bazuar nga të dhënat më lartë shohim se shpenzimet më të vogla janë tek furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës me 0.3 dhe 1%, në sektorin e akomodimit dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 0.5 dhe 1.1% etj.

Grafikoni 4. Shpenzimet sipas seksioneve ekonomike për vitet 2008-2013



Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare Kosovës “Pjetër Bogdani”

311.312:(496.51) “2008/2013”:338.4(083.41)

Rezultatet e anketës strukturore të ndërmarrjeve 2008-2013 /
[Publikimi është përgatitur nga Ilir T. Berisha...et al.]. - Prishtinë :
Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2015. - 17 f. : ilustr. ; 28 cm. -
(Seria 3 : Statistikat Ekonomike)

Parathënie / Isa Krasniqi: f. 5

1. Berisha, Ilir T.

ISBN 978-9951-22-181-8

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese;* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. *Departamentet mbështetëse;* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyrat Rajonale; Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj**

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 139 punëtorë, prej tyre, 104 (74,8%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 35 (25,2%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 70,5% me shkollim universitar ndërsa 29,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë. Në vijim e sipër është përgatitja për Regjistrimin e Bujqësisë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** economic@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-22-181-8



9 789951 221818